

**VENDIM****Nr. 164, datë 19.2.2020****PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR
ZHVILLIM, NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE DURRËS, BASHKIA
DURRËS, DHE CAKTIMIN E FONDIT
SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI
ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjeve “iii” e “iv”, të shkronjës “b”, të nenit 13, dhe të pikës 3, të nenit 16, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të Faqe|1862

fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, të zonës 4, Njësia Administrative Durrës, Bashkia Durrës, zonë e re për zhvillim.

2. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit për këtë zonë, si njësi zbatuese, për:

a) ndërtimin e banesave të reja ose të ndërtesave publike të dëmtuara;



- b) ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike e kritike;
- c) realizimin e ndërtimeve në këtë zonë;
- ç) çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të kësaj zone.

Durrës dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia

KRYEMINISTËR
Edi Rama

